Kosovo's Serb-dominated north is preparing to take part in Kosovo's local elections for the first time since Kosovo declared its independence in February 2008. Though Belgrade and Pristina agreed to hold Kosovo's elections in the north, dismantle parallel institutions, and set up Kosovo local institutions, many representatives of the Serb community there remain skeptical about the voting and the subsequent formation of these institutions. Many predict a low turnout of about 20 percent and foresee formidable challenges in setting up the new local institutions. Particularly challenging will be the integration of parallel security structures into Kosovo's structures.

Serb representatives in the north express a number of concerns regarding integration into Kosovo's institutions—such as a loss of jobs due to the expected reduction of local administration, the unlikelihood of Kosovo's police to hire all Serb police officers operating in the north, uncertainty about the jobs of those employed in idle public companies, lower salaries in Kosovo's institutions than in Serbia's—but the overarching reason against integration remains their rejection of the Kosovo state.

Elections in the north

Kosovo's November 3 election is the first local election in the north since Kosovo's independence. Serbia and local Serbs in the north organized a number of their own elections and established institutions that operated according to Serbian law. The new election is a result of the Brussels agreement that calls for an election according to Kosovo law. The majority of participants from the north said that the agreement does not clarify what will happen to those who worked in the parallel system—whether they will all be employed in the new institutions—and does not explain under what laws the new institutions will operate and the relations they will have with Belgrade. Many speakers, however, said that the agreement clearly indicates that the new institutions will operate according to Kosovo's laws and added that Serbian government officials do not admit it publicly for political reasons.

Many pointed out that the timing of the Brussels agreement corresponded with Serbia's intensified efforts to make progress toward European integration rather than with the



From left to right: Krystyna Marty, Alex Grigorev, Norbert Rüttsche, and Vladimir Božović

interests of the local population in the north. However, a number of speakers said that the election and establishment of institutions recognized by Pristina and the international community is in the interest of the Serb community too. "The north will finally have institutions recognized by everyone," a speaker noted.

There was consensus that politicians should create a better climate for electoral participation. Kosovo and Serbian officials should refrain from rhetoric that increases tensions and provokes the population. Some strongly criticized the stance of the Serbian government to support only one Serb party, known as the government list, thus implying that other Serb parties and initiatives do not represent Serb interests. Mayoral candidates should be supported and encouraged by all stakeholders. "Some in the Serbian government support only certain candidates while hurting the process, especially when some believe that only those on the state list will get jobs and benefits. It is not democratic for a government to try to impose voting choices on the people," a speaker argued.

Many participants predicted that without a better political and security climate the turnout will be extremely low. Some said that at best it would reach about 20 percent. A speaker said that the continuing existence of barricades in the north signifies the northern Serbs' lack of trust in Kosovo's institutions and an objection to integration. Voters should be told what the elections will bring, whose laws will be used in establishing institutions, what will happen with their jobs, with their retirement contributions, healthcare, and education. "If they will not get clear answers on these issues, turnout will not be high and elections cannot be declared a success," a speaker said. The agreement only says that elections will be held according to Kosovo's laws, but not that the institutions will function according to the same laws. For the people in the north, this is not about elections; it is about their status, whether they would become Kosovars or remain Serb citizens, the speaker argued.

Security during the elections remains the most serious concern. Some speakers reported that there are security structures in the north that could threaten the process, and suggested that EULEX and KFOR be more active. They also recommended that Belgrade should be more decisive and send a clear message to those who may plan to resort to violence.



From left to right: Ardian Gjini, Rada Kapetanović, Shpetim Gashi, Danijela Vujičić, Besa Shahini, Marko Jakšić, and Milivoje Mihajlović



From left to right: Arbër Vllahiu, Smiljka Milisavljević, Samuel Žbogar, and Jean-Daniel Ruch

To create a conducive climate to free and fair elections, participants suggested a number of steps:

1. **The Serbian government should not take sides between Kosovo Serb political parties running in the elections.** Belgrade should support all Serb parties and not take sides between them. Statements of Serbian officials calling on Serb voters to support the government's list are not democratic and contribute to the Serb community's division. Belgrade's position to support one party divides the Serbs into patriots and traitors and implies that those parties that are not part of the "list" do not represent Serb interests. The Serbian parties, including governing parties, could support certain Serb parties in Kosovo but not the Serbian government. This is simply an SNS-SPS list, not a government list.
2. **Pristina, Belgrade, and the international community should ensure the safety of those running for office and prevent voter intimidation.** KP, EULEX and KFOR should ensure the safety of those running for office and deter intimidation campaigns. They should also closely cooperate in shedding light on recent intimidation incidents against candidates for elections in the north, and especially in identifying and apprehending the perpetrators of the murder of an EULEX customs officer. These institutions should send a clear message to those committing these crimes that their actions will not go unpunished by acting swiftly and resolving these cases.
3. **Pristina, Belgrade, and the Serbs in the north should refrain from provocative statements and actions during the election campaign.** These actors should take responsibility to ensure a successful election and avoid statements and actions that could undermine turnout. Pristina should allow Serbian officials to visit Kosovo. Belgrade should focus on issues of local interest and not interpret elections as "strengthening the Serbian state in Kosovo," but rather as "strengthening the Serb community in Kosovo." Serb candidates in the north should focus on local issues and not use nationalist rhetoric during the campaign. A successful election would not only have a significant impact in ensuring a better future for the north but also would improve relations between Belgrade and Pristina and create a conducive climate for interethnic trust and cooperation throughout Kosovo.

Establishing local institutions

According to Kosovo's laws, municipalities have substantial autonomy in budgetary planning and spending, but the majority of the funds come from government grants. To receive such grants, municipalities in the north would have to accept and cooperate with central authorities in Pristina. Belgrade will not continue funding of political structures. Thus cooperation between local institutions in the north and Pristina is crucial.

Election turnout is another important factor for the legitimacy of the institutions. "This election is a referendum on integration into Kosovo's system rather than an election to establish institutions," said a speaker. Low turnout may make it difficult for the elected officials to claim wide legitimacy. Uncertainty is the main factor for expected low turnout. It is uncertain how much political and financial attention Pristina would pay to the region. And what is certain is that the local people will carry the cost of transition, but they will also reap its benefits. Many feel betrayed by Belgrade, that after 14 years it is throwing them into an uncertain future. But people in the north can create certainty by getting involved in the process themselves and not wait for Brussels, Pristina, or Belgrade. The message of the participants was that Kosovo's authorities should support the north financially and politically and "treat it as their own territory and people."

To create functional institutions in the north, participants suggested a number of steps:

1. **Stakeholders should create political stability in the north.** Serbs in the north should cooperate with Pristina, Belgrade and the international community. Pristina, Belgrade, and the international community should minimize the cost of transition through creating more jobs in public administration, the development fund, and by encouraging private investment. They should also make the benefits of the transition more visible.
2. **International organizations, such as OSCE, should organize trainings for election and local administration officials.** Local and international stakeholders should build an efficient and professional local administration. Efficient services would increase the public credibility of these institutions and ameliorate the political objections that Serbs have towards Kosovo's institutions. In this regard, Pristina and international organizations, such as OSCE, European Commission, and foreign embassies in Kosovo, should support training programs for the administrative staff.
3. **Establish a working relationship with Kosovo's central institutions.** The largest chunk of municipal budgets comes from Kosovo government grants because local revenues are insignificant. This will be specifically the case with the municipalities in the north. Thus it is important to establish a good relationship with the central institutions to receive the grants on time and request specific funds for certain areas in need.

BUILDING INSTITUTIONS IN THE NORTH

Brussels, Belgium, December 2013

Northern Serbs voted in solid numbers in the November 3 election. In Kosovo overall, the Belgrade-backed Srpska list won in 9 of the 10 Serb-majority municipalities, including all four in the north. Though marred with irregularities and an aggressive intimidation campaign, the election was successful in that it produced elected officials and created the conditions for establishing institutions recognized by all stakeholders.

The integration process, however, foresees a number of challenging steps in the upcoming days. These are the establishment of the new local institutions and the transformation of the old ones, ensuring that these new institutions function according to Kosovo law, promoting cooperation between local institutions and Kosovo's central institutions, and the formation of the Association/Community of the Serb-majority Municipalities. These steps were the focus of the CIG roundtable held in December 2013 in Brussels, Belgium. A number of participants from Kosovo and Serbia also had a discussion with members of the European Parliament's Delegation for the Western Balkans.

The newly-elected representatives in the north had been the most vocal against Kosovo's institutions, but now they have to establish and themselves run such institutions. Pristina had also refused to meet with many of these representatives when they headed the parallel institutions, but now it will have to work with them. Many expect this relationship will be tense and challenging. The first test will be the convening of the assemblies and establishing of the new administrations according to Kosovo law.

The participants recommended that the mayors begin communication with Pristina immediately and in line with the existing Kosovo laws. They particularly encouraged the mayors to focus more on issues and policies that respond to concerns of their constituents—providing utilities such as water and electricity, improving the road infrastructure, employment—and less on politics. The mayors should also establish local administrations immediately and begin to provide services. Participants supported the full implementation of the Brussels agreement and called on all sides to do their part. There was consensus that economic development is the key to economic stability in the north, and called on the mayors to create an environment conducive to foreign assistance and investment.

Establishing local institutions

The transformation of the Serb parallel institutions in the north into Kosovo's institutions through a Kosovo local election appears to be more complicated than the establishment of the Serb-majority municipalities south of the Ibar River four years ago. Particularly complicated is the integration of hundreds of members of informal security structures, such as the civil protection and Serbian police officers, into Kosovo's respective structures. The Serbian authorities have submitted a list of 337 members of the Serbian police to Kosovo authorities, which will recruit between 250 and 270 into KP. Kosovo's intelligence agency

and EULEX are reviewing the applications. Members of the civil protection force will also be integrated into the police and security force according to the same procedures.

The Kosovo Albanians question the loyalty of these members to Kosovo's institutions. Some said that

not only had they been at the forefront of resistance to Kosovo's institutions, but that they also refuse to recognize Kosovo's sovereignty. Many speakers also said that the statements of various Serbian officials that the new local institutions will "strengthen the state of Serbia in Kosovo" do not contribute to a climate of cooperation and tolerance either. A number of Serb speakers said the integration of the Serb members will take place according to the Brussels agreement, which, according to them, is status neutral. Some of the officials argued that they will not recognize Kosovo's independence and its institutions but will try to cooperate with them in the spirit of the agreement. They agreed to take the oath of office, but not "because they recognize the institutions of Kosovo but because the oath does not mention the Republic of Kosovo." Though this may help to convene the assemblies, it is no solution, as the mayors will be confronted from the very first day with many documents with the logo of the Republic of Kosovo.

The first test will be the convening of the assemblies and the creation of municipal institutions according to Kosovo law. According to the local governance law, the municipal assemblies should convene 15 days and mayors should take the oath 30 days after the Central Election Commission certifies the election results. If the mayors fail to take the oath, the Commission is required to organize a new election. Some Serb participants suggested that the local institutions should not be formed until the association is formed.

Implementation of Kosovo's laws by local institutions in the north and their cooperation with Pristina is key to the successful integration. Revenues from municipal sources are negligible; as municipalities rely on funds from the central budget. Many speakers suggested that the Serb mayors in the north should begin to talk themselves with Pristina, and not wait for Belgrade to discuss every detail on their behalf. They recommended that the local administration should be recruited as soon as possible and services should be provided immediately.

Cooperation is also a condition set by the international community. The European Union has allocated 38.5 million euros for the north for the first year, but its officials say the funds are contingent upon the north's cooperation with Pristina, the international community and the implementation of the laws. Many speakers said the implementation of Kosovo laws is not negotiable, and believed that the EU funds are a solid incentive to promote



Meeting at the European Parliament in Brussels

cooperation. In addition to the EU's 38.5 million, the four municipalities will also receive additional funds from central authorities, local revenues, and the development fund for the north. In total, the funds for the north will be about 60 million euros. To put this amount into context, the north with about 40 thousand inhabitants will have an equivalent budget to that of the city of Pristina, which has about 200,000 inhabitants.

Association: an integrative or divisive force?

The objective of the association is to connect the Serb-majority municipalities with each other and serve as an umbrella organization representing the interests of the Serb community. Kosovo officials say they agreed to the association in exchange for the dismantling of the parallel system in the north. The association remains one of the most contentious issues of the Brussels agreement. The Albanian participants argued that it would further divide Albanian and Serb societies, create a separate Serb entity within Kosovo, and undermine the state of Kosovo and the concept of multiethnicity. But a number of Serb speakers argued that the association would represent the interests of the Serb community in a more organized way and act as a unified Serb body in Kosovo. They also added that it should have solid legislative and executive powers, including some currently held by the municipalities.

The mandate and role of the association has yet to be defined. The Kosovo prime minister has said that the association will simply be a consultative mechanism without any executive or legislative powers. The Serbian prime minister, on the other hand, said that the body will have executive powers in areas of security, the judiciary, education, health, urban planning, and economic development. Representatives of the international community, including the US and German ambassadors in Kosovo, have recently recognized in separate interviews that there are tendencies in Belgrade to form a version of Republika Srpska in the north but said that they will not allow it. Members of the opposition Self-determination movement argue that stopping it is too late and blame Kosovo's government for creating a separate entity in the north.



Roundtable in Brussels



Left to right: Samuel Žbogar, Krstimir Pantić, Leon Malazogu, Vladimir Božović, Sadri Ferati, Nenad Đurđević, Qemajl Marmullakaj, and Dejan Radenković

What is known about the association is that it will not have an elected legislative body and that its leadership will include mayors and other members of local institutions of the Serb majority municipalities. Some of these municipalities, such as Novobërde/Novo Brdo, Shtërpce/Strpce, and North Mitrovica have substantial Albanian populations. The debate over these questions is heated and is creating tensions between the communities. Participants suggested that an agreement on this mechanism should be reached soon.

Conclusions and recommendations

The following is a list of conclusions and recommendations that came out of the discussions.

1. **Pristina-Belgrade dialogue on Kosovo's internal issues should be phased out.** The dialogue should continue only on bilateral issues, such as economic cooperation, energy, regional cooperation, and European integration. The remaining internal issues should be discussed between Pristina and Kosovo Serbs.
2. **Mayors should begin to talk directly with Pristina and not continue to rely on Belgrade.** Not only is this a responsibility given to them by their electorate, but also because Belgrade may not be able to negotiate every local issue that will come up during the agreement's implementation on their behalf. Representatives of Kosovo's institutions, including the prime minister, and mayors in the north have expressed willingness to have direct meetings.
3. **The EU 38.5 million euros for the north should be used for development projects.** Members of the international community called on the newly-elected mayors to set up their administrations as soon as possible and begin to use the money. They also called on them to employ experts who are able to use these funds for development projects.
4. **The details of the association should be agreed upon soon and bring to an end the heated debate over this issue.** The debate about the association has widened the gap between Albanians and Serbs regarding the Brussels agreement. Albanians claim that the association sets the stage for the creation of a Republika Srpska in Kosovo. The Serbs, on the other hand, argue that only a strong association can

guarantee their rights in Kosovo. Both sides claim that the association will have certain powers but so far there is no agreement on the details of the association.

5. **Mayors of Serb-majority municipalities should operate within Kosovo's legal framework.** Whether the mayors of the Serb-majority municipalities recognize Kosovo's independence or not is not important as long as they operate within Kosovo's framework.
6. **Local institutions should focus on local issues.** Local candidates in Albanian-majority municipalities focused primarily on local issues such as water and roads and local governance. In contrast, Serb candidates focused almost entirely on national politics, especially on Serbia's role in Kosovo. But once they assume their positions, the mayors and members of local assemblies, especially those in the north, should focus on local issues and respond to local concerns.

VERIU I KOSOVËS

Nga barrikadat tek integrimi

Parathenia dhe falenderimet

Marrëdhënie të tensionuara mes Kosovës e Serbisë vazhdojnë të dominojnë politikën e Ballkanit, dhe askund tjetër nuk ndjehet një gjë e tillë më shumë se në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. Për katërmbëdhjetë vite, të përkrahur nga qeveria në Beograd, serbët atje kanë refuzuar integrimin në sistemin e pavarur të Kosovës. Në anën tjetër, Prishtina nuk ka qenë në gjendje ta vendosë kontrollin në këtë pjesë të territorit, dhe përpjekjet e saj për t'i inkurajuar serbët që ta pranojnë integrimin, kanë qenë të pamjaftueshme. Si pasojë e kësaj, veriu ka vazhduar të jetë kërcënim madhor për stabilitetin e rajonit.

Për ti adresuar këto çështje kritike dhe me qëllim të ofrimit të një platforme të rallë për diskutime të hapura dhe dhë joformale kokë më kokë, mes zyrtarëve të lartë qeveritarë e partiak nga Kosova e Serbia, udhëheqësve serbë të Kosovës (sidomos atyre nga veriu), dhe analistëve kryesorë nga Kosova e Serbia, Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG), me përkrahjen zemërgjërë të Departamentit Federal Zvicrran të Punëve të Jashtme (FDFA), dhe në bashkëpunim me ambasadat zvicerane në Prishtinë dhe Beograd, gjatë periudhës 2012-2013, ka ndërmarrë një program në kohëzgjatje prej një vit e gjysëm, të titulluar "Gjetja e zgjidhjeve për Veriun e Kosovës". Zyrtarët e BE-së dhe SHBA-së kanë marrë pjesë gjithashtu.

Idea për këto diskutime ka dalur nga bashkëbisedimet tona me politikanë e analistë në Kosovë dhe Serbi, si dhe nga konsultimet me diplomatë në Bern, Bruksel dhe Uashington.

Përmes gjashtë tryezave të rrumbullakëta jashtë Kosovës e Serbisë, dhe një numri sesionesh tjera në Kosovë dhe Serbi, CIG ka lehtësuar eksplorimin e përbashkët nga ana e pjesëmarrësve të mënyrave për zgjidhjen e çështjeve diskutabile në veri, dhe për ti rekomanduar qeverisë së Kosovës dhe Serbisë hapa afatshkurtër dhe afatgjatë të cilët do të mund ti ndërmerrnin për të ndërtuar besimin e ndërsjellë dhe për të përmirësuar marrëdhëniet.

Këto diskutime të moderuara nga CIG janë zhvilluar në të njëjtën kohë me dialogun zyrtar mes kryeministrave të Serbisë dhe Kosovës, Ivica Dačić dhe Hashim Thaçi, të ndërmjetësuar nga përfaqësuesja e lartë për politikë të jashtme dhe siguri e Bashkimit Evropian, Catherine Ashton. Kulmi i dialogut kanë qenë pesëmbëdhjetë pikat e "Marrëveshjes për Principet e Qeverisjes dhe Normalizimit të Marrëdhënieve", të nënshkruar formalisht nga dy kryeministrat, më 19 prill të vitit 2013, në Bruksel. Marrëveshja ka qenë dëshmi se një perspektivë serioze e anëtarësimit në Bashkimin Evropian mbetet nxitja e vetme më e rëndësishme për stabilizimin e Ballkanit, përfshirë këtu edhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes Kosovës dhe Serbisë.

Edhe pse një numër i çështjeve bilaterale mes Beogradit e Prishtinës mbeten ende të pazgjidhura, posaçërisht çështja e statusit të Kosovës, marrëveshja e Brukselit ka shënuar fillimin e zgjidhjes së çështjeve në veri. Megjithatë, përshtypja e parë se Beogradi dhe Prishtina më në fund mund të kenë qëllime të njëjta, shumë shpejtë doli të jetë shumë larg realitetit. Sfidat në procesin e implementimit janë shumë të mëdha, dhe marrëveshja mes dy kryeministrave ka pasur shumë pak ndikim tek zyrtarët dhe politikanët e niveleve më të ulëta, apo tek qytetarët e thjeshtë.

Pas prillit të vitit 2013, qëllimet kryesore të aktiviteteve të CIG kanë qenë asistencë në implementimin e Marrëveshjes së Brukselit, dhe ndihma për mbushur boshllëkun e pritjeve, dhe për ndërtimin e besimit mes zyrtarëve në Prishtinë dhe Beograd, dhe mes Prishtinës dhe serbëve të veriut.

Pjesa dërrmuese e serbëve në veriun e Kosovës e kanë parë marrëveshjen ose me skepticizëm, ose me refuzim të menjëhershëm. Edhe pse zgjidhja e mosmarrëveshjes në veri do të varet nga politikat e zgjedhura dhe vendimet e marra në Prishtinë dhe Beograd, fitimi i bashkëpunimit të serbëve të veriut është kyç për të garantuar një proces të rregullt të implementimit dhe të sigurisë në Kosovës.

Dy fusha të rëndësishme mbeten ende thelbësore për përmirësimin e stabilitetit në Kosovës. E para është normalizimi i veriut përmes zbatimit të plotë të Marrëveshjes së Brukselit, apo thënë ndryshe, vendosja e institucioneve lokale funksionale dhe bashkëpunimi i tyre me qeverinë e Kosovës, përmirësimi i sigurisë, arritja e përmirësimeve të shpejta dhe të dukshme në terren, dhe adresimi i problemeve jetësore të popullatës së veriut (serbët, shqiptarët dhe të tjerët), e posaçërisht papunësisë. Edhe BE-ja e edhe qeveria e Kosovës kanë siguruar fonde substanciale për këtë qëllim. Ajo çka mungon është vullneti më i madh politik dhe angazhimi prej palëve të ndryshme.

Diskutimet e CIG poashtu kane vënë në pah një tjetër çështje kyçe e cila pritet të zgjidhet – vendosjen e asociacionit/komunitetit të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Nuk ekziston një marrëveshje rreth kësaj çështjeje mes Beogradit e Prishtinës, rreth rolit të asociacionit, marrëdhënies së tij me institucionet e Kosovës dhe komunat anëtare, përfaqësimin e shqiptarëve etnik dhe të tjerëve joserbë të cilët jetojnë në këto komuna apo serbët etnik që jetojnë jashtë këtyre komunave. Çështja kryesore është nëse ky organizëm i ri do të jetë mjet për integrim apo për ndarje. Përgjigjja në këtë pyetje do ta vendosë fatin e marrëveshjeve të ardhshme mes serbëve e shqiptarëve në Kosovë.

CIG është i vendosur të kontribuojë në këto dy fusha. Përkundër pikëpamjeve të kundërta të pjesëmarrësve, tryezat e rrumbullakëta të CIG janë shëndrruar në klubin e tyre, ku ata mund të krijojnë dialog të hapur dhe të sinqertë, shpesh duke mos u pajtuar mes vete, por megjithatë duke punuar së bashku në kërkim të zgjidhjeve paqësore dhe të pranueshme për problemet e vështira. Për më shumë, pjesëmarrësit shpeshherë kanë dalur me rekomandime të rëndësishme të politikave. Ne të gjithë u jemi mirënjohës pjesëmarrësve për kontributin e tyre. Rigrupimi dhe forcimi i këtij klubi të veçantë, dhe ndihma për të vazhduar ndikimin në politikat në Kosovë dhe Serbi, do të jenë qëllimet kryesore të CIG në periudhën në vazhdim.

Jemi krenar për bashkëpunimin tonë me FDFA zvicerane, dhe u jemi pafundësisht falenderues kolegëve dhe miqve tanë, posaçërisht ambasadorëve Krystyna Marty, Jean-Daniel Ruch dhe Claude Wild, gjithashtu Norbert Rüttsche, Roland Salvisberg dhe Talia Wohl për mbështetjen e tyre të pakursyer për aktivitetet e CIG, besimin e tyre në misionin tonë dhe bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm. Pa kontributin e tyre kjo iniciative nuk do të ishte e mundur.

Gjithashtu, u jemi falenderues shumë miqve tanë në Parlamentin Evropian dhe Komisionin Evropian, posaçërisht në Direktoratin Gjeneral për Zgjerim, dhe në Departamentin Amerikan të Shtetit për pjesëmarrjen dhe përkrahjen e tyre për përpjekjet tona. Falenderimet tona të veçanta shkojnë për Përfaqësuesin Special të BE-së në Kosovë, Samuel Žbogar, për kontributin e tij të çmueshëm në këto diskutime.

E shfrytëzojmë këtë mundëti të falenderojmë poashtu anëtarët e bordit të drejtorëve të CIG, Dr. Steven L. Burg, Dr. Gordon N. Bardos dhe Michael W. Elf, për përfshirjen e tyre aktive në punën e CIG, këshillat e mira dhe përkrahjen.

Zëvendëspresidenti i CIG, Shpëtim Gashi është autor i këtij raporti dhe ka qenë thelbësor në implementimin e këtij programi. Kolegët tanë në Evropë, Arbër Kuçi dhe Igor Novaković kanë kontribuar poashtu.

Ky raport i CIG përmbledh diskutimet e tryezave të rrumbullakëta dhe prezanton para lexuesve pikëpamjet e kundërta të pjesëmarrësve, si dhe pikat e pajtimit mes tyre. Raporti poashtu është dëshmi e evolucionit shumë të shpejtë të çështjes së veriut të Kosovës, gjë që vërehet edhe nga titulli i këtij raporti. CIG merr gjithë përgjegjësinë për këtë publikim i cili nuk është lexuar paraprakisht nga pjesëmarrësit.

Alex Roinishvili Grigorev, Kryetar

*Nju Jork
Janar 2014*

Hyrje

Ky raport dokumenton një sërë diskutimesh joformale mes shqiptarëve të Kosovës, serbëve të Kosovës, dhe përfaqësuesve serbë nga Serbia, në lidhje me çështjen e veriut të Kosovës dhe dialogun Prishtinë-Beograd. Qëllimi i projektit ka qenë ti ndihmoj politikbërësit në Kosovë dhe Serbi në zgjidhjen e çështjes së veriut të Kosovës dhe kontribuimi në përmirësimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, përmes ekzaminimit të përbashkët të këtyre çështjeve dhe ofrimit të rekomandimeve joformale. Projekti ka shërbyer si arenë në të cilën pjesëmarrësit kanë shkëmbyer dhe testuar idetë, parimet dhe zgjedhjet e politikave.

Ky raport është përbledhje e gjashtë tryezave të rrumbullakëta në radhitje kronologjike. Diskutimet janë zhvilluar në Budvë, Mal i Zi; Stamboll, Turqi; Shkup, Maqedoni; dhe Bruksel, Belgjikë. Pjesëmarrësit kanë qenë anëtarë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Partia e Pavarur Liberale (SLS), Lista e Bashkuar Serbe (JSL), qeveria e Kosovës dhe zyra e presidentes; dhe nga Partia Progresive Serbe (SNS), Partia Demokratike (DS), Partia Socialiste e Serbisë (SPS), Rajonet e Bashkuara të Serbië (URS), Partia Liberal Demokrate (LDP), dhe qeveria e Serbisë dhe zyra e presidentit. Një numër analistësh nga Kosova dhe Serbia dhe përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar poashtu kanë marrë pjesë.

Tryeza e parë është përshkruar nga një konsensus se status quo-ja në veri nuk është e qëndrueshme dhe pjesëmarrësit kanë ofruar një numër opsionesh për ta zëvendësuar paralelizmin institucional. Tryeza e dytë ka qenë e fokusuar në organizimin e zgjedhjeve në veri dhe vendosjen e institucioneve të reja. Pjesëmarrësit nuk janë pajtuar rreth asaj se cili legjislacion duhet të përdoret, por janë pajtuar se OSBE-ja do të ishte një akter i përshtatshëm për të marrë përgjegjësinë e organizimit. Tryeza e tretë ka qenë e fokusuar në sfidat e tranzicionit, posaçërisht në shpërbërjen dhe riintegrimin e institucioneve paralele. Pjesëmarrësit kanë dhënë një numër hapash të cilët do të duhej ti ndërmerrnin Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar për të minimizuar koston e tranzicionit për popullatën lokale.

Tryeza e katërt është zhvilluar pas marrëveshjes së Brukselit të prillit të vitit 2013. Pjesëmarrësit kanë inkurajuar serbët e veriut të marrin më shumë përgjegjësi për të ardhmen e tyre dhe të përfshihen në procesin e implementimit. Tryeza e pestë ka qenë e koncentruar në zgjedhjet lokale në veri. Pjesëmarrësit kanë rekomanduar një numër hapash për të garantuar një proces të lirë dhe të drejtë, si dhe kanë propozuar veprime për të transformuar institucionet ekzistuese. Tryeza e fundit e rrumbullakët është zhvilluar pas zgjedhjeve lokale. Kjo tryezë ka qenë e fokusuar në formimin e institucioneve të reja dhe marrëdhëniet mes këtyre institucioneve dhe institucioneve qendrore të Kosovës.

Shpëtim Gashi, zëvendëskryetar i CIG, është autor i këtij raporti.

Për të inkurajuar diskutim të sinqertë, CIG nuk i atribuon të thënat gjatë diskutimeve pjesëmarrësve specifik. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në këtë projekt në kapacitetet e tyre personale dhe pozicionet e tyre nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të organizatave që ata përfaqësojnë.

ALTERNATIVAT NDAJ PARALELIZMIT

Budvë, Mali i Zi, tetor 2012

Qëllimi i kësaj tryeze ka qenë që të fillohet një sesion jorformal i shoshitjes së ideve rreth transformimit të paralelizmit institucional në veriun e Kosovës në një sistem të njohur nga të gjitha palët. Një numër i pjesëmarrësve serbë kanë kundërshtuar shpërbërjen e institucioneve paralele nën çfarëdo rrethanash. Ata poashtu kanë pasur shumë vetëbesim se as Beogradi nuk do të pajtohej me këtë, pasi që një gjë e tillë do t'i jepte legjitimitet pavarësisht së Kosovës. Por Beogradi, pas trysnisë së fuqishme ndërkombëtare, tashmë veçse e kishte nënshkruar një marrëveshje me Prishtinën, menaxhimin e integruar të kufirit (IBM). Një grup tjetër i folësve serbë janë pajtuar për shpërbërjen e institucioneve paralele të veriut, por vetëm pasi që një marrëveshje të jetë arritur për ti zëvendësuar ato me një grup tjetër institucionesh. Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës, në anën tjetër, kanë argumentuar se vendosja e institucioneve të Kosovës është opsioni i vetëm dhe se korniza legjislative e Kosovës nuk është e negociueshme.

Shumica e pjesëmarrësve serbë kanë thënë se veriu, pavarësisht se a mbetet pjesë e Kosovës apo Serbisë, do të duhej të kishte autonomi substanciale politike dhe ekonomike. Ata kanë pranuar se ka nevojë që të krijohen institucione të cilat do të njiheshin nga Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar. Një numër folësish poashtu kanë ngritur çështjen e strukturave joformale të sigurisë në veri, të cilat janë parë nga disa pjesëmarrës si organizata që “ofrojnë pasiguri” në vend të sigurisë. Disa kanë thënë se udhëheqësit e vërtetë në veri nuk janë kryetarët e komunave, por krrerët e këtyre strukturave të sigurisë.

Përmirësimi i sigurisë është konsideruar parakusht për implementimin e marrëveshjes eventuale politike. Pjesëmarrësisht kanë rekomanduar largimin e të gjitha barrikadave, por në këmbim të kësaj kanë kërkuar garanca se intervenimi i qershorit të vitit 2011 nga policia e Kosovës nuk do të përsëritet. Edhe pse e kanë konfirmuar se policia nuk do të provojë të intervenojë, pjesëmarrësit shqiptarë kanë thënë se Prishtina nuk do të heqë formalisht dorë nga e drejta e saj për të intervenuar në territorin e vet.

Dialog në dy korsi

Shumë pjesëmarrës kanë rekomanduar një dialog në dy korsi – një mes Prishtinës dhe serbëve të veriut të Kosovës, dhe një mes Prishtinës dhe Beogradit. E para ka mbështetjen e partive parlamentare, por kundërshtohet nga shumica e serbëve në veri dhe në Beograd, të cilët kanë qëndrimin se vetëm Beogradi mund të negociojë me Prishtinën. Kurse e dyta mbështetet nga Beogradi dhe serbët në veri, por kundërshtohet nga një numër i partive politike të Kosovës, posaçërisht nga partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, të cilët argumentojnë se Prishtina nuk do të duhej të fliste me shtetet tjera rreth çështjeve të saja të brendshme.

Serbët nga veriu frikësohen se e ardhmja e dialogut rreth veriut do të dominohet nga interesat e Beogradit dhe Prishtinës, e jo nga ato të tyre. Disa zyrtarë serbë kanë ritheksuar se e ardhmja e shtatë milion serbëve në Serbi nuk do të mbahet peng i së

ardhmes së 40 mijë serbëve në veriun e Kosovës. Serbët nga veriu i kanë bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar që të ketë bashkëbisedime të shpeshta me përfaqësuesit e katër komunave veriore. Disa kanë thënë se Beogradi, Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar do të duhej poashtu të marrin përshtypjet dhe mendimet e atyre të cilët nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në politikë.

Përderisa folësit serbë kanë preferuar një marrëveshje në pako, përfaqësuesit shqiptarë kanë propozuar një qasje më graduale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes: heqjen e barrikadave, vendosjen e doganave të Kosovës dhe rekrutimin e zyrtarëve të rinj doganor, kryesisht serbë; organizimin e zgjedhjeve lokale të Kosovës; ngritjen e institucioneve lokale; dhe forcimin e forcës zyrtare policore si dhe shpërbërjen e strukturave të sigurisë. Por, shumica kanë besuar se këta hapa nuk janë të mundur pa arritur paraprakisht një marrëveshje të gjërë politike, dhe roli i Beogradit në të është thelbësor.

Shumë pjesëmarrës shqiptarë kanë pranuar se roli i Beogradit është i pashmangshëm në dizajnimin e zgjidhjes për veriun. Ka ekzistuar një konsensus se komuniteti ndërkombëtar do të duhej të merrte rolin udhëheqës në dizajnimin e zgjidhjes. Komuniteti ndërkombëtar poashtu duhet të ushtrojë trysni tek Beogradi dhe Prishtina në mënyrë që ata tu përmbahen zotimeve të tyre për implementimin e marrëveshjes së arritur në Bruksel, posaçërisht për implementimin e IBM-së.

Opsionet për veriun

Akterët ndërkombëtar, përfshirë edhe ata të cilët nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, e konsiderojnë Kosovën si një njësi të vetme territoriale. Ata përkrahin një zgjidhje e cila e mban veriun brenda Kosovës, duke përjashtuar kështu ndarjen si zgjidhje. Disa anëtarë të BE-së poashtu kërkojnë nga Beogradi t'i shpërbëjë dhe të ndalojë së financuari strukturat paralele në veri. Por zyrtarët qeveritarë serbë dhe serbët në veri thonë se ligjet e Serbisë duhet të vazhdojnë të zbatohen atje.

Pjesëmarrësit shqiptarë kanë thënë se vetëm zgjedhjet e Kosovës janë të pranueshme për Prishtinën. Ata kanë thënë se një kombinim i legjisllacionit, i propozuar nga disa, nuk është i pranueshëm. Ata janë pajtuar që OSBE-ja do të mund të organizonte zgjedhjet, por vetëm sipas ligjeve të Kosovës. Por shumë serbë kanë thënë se ata do ta parandalonin mbajtjen e zgjedhjeve të Kosovës.

Për ndryshim nga shqiptarët, të cilët kanë preferuar një qasje graduale, serbët mbështesin një zgjidhje në pako. Opsionet përfshijnë autonominë rajonale, vetëqeverisjen e përkohshme, si dhe një formë të protektoratit ndërkombëtar. Një nivel i vetëqeverisjes përmes "leximit kreativ të planit të Ahtisaarit" është një mundësi, kanë thënë një numër i pjesëmarrësve serbë e shqiptarë. Ata kanë parashikuar që zgjidhja përfundimtare do të bazohet në planin e Ahtisaarit, por do të përfshijë disa kompetenca shtesë të qeverisjes lokale. Ka ekzistuar pothuajse një konsensus i plotë se ndarja nuk duhet të konsiderohet si option.

Autonomia rajonale, e pëlqyer nga disa pjesëmarrës serbë, do t'iu mundësonte katër komunave të operonin në bazë të ligjeve të Kosovës, por të njejtat do ti kishin asambletë

e zgjedhura nga vetë ata, si dhe një administratë nën mbikqyrjen ndërkombëtare. Por, për të zbatuar një option të tillë, kushtetuta e Kosovës do të duhej ndryshuar, pasi që ajo nuk lejon krijimin e autonomive rajonale.

Qeverisja e përkohshme fillimisht do të bazohet në ligjet e Serbisë, por ligjet e Kosovës do të prezantoheshin gradualisht. Në thelb, ky option do të legalizonte institucionet paralele në veri, me qëllimin afatgjatë të integritetit të tyre në sistemin e Kosovës.

Protektorati ndërkombëtar do të mundësonte vendosjen e një zyrtari ndërkombëtar, i cili për një kohë të shkurtër, do të kishte fuqi ekzekutive në të katër komunat. Serbët poashtu do të zgjedhnin kryetarët e komunave dhe administratat komunale, por do të ishin nën autoritetin e zyrtarit të emëruar ndërkombëtar.

Pjesëmarrësit shqiptarë kanë përkrahur të ashtuquajturin "option gjerman", i cili bën thirrje për një shpërbërje të menjëhershme të institucioneve paralele dhe organizimin e zgjedhjeve të Kosovës në veri.

Përfundimet dhe rekomandimet

Përfundimet dhe rekomandimet nuk janë të bazuara në konsensus, por janë dhënë nga një apo më shumë pjesëmarrës.

1. **Të organizohet një dialog në dy korsi rreth veriut.** Një korsi duhet të jetë mes Prishtinës dhe serbëve në veri, dhe tjetra mes Prishtinës e Beogradit. E para do t'i adresonte çështjet lokale në veri, kurse e dyta, do t'i adresonte marrëdhëniet mes Prishtinës e Beogradit.
2. **Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të marrin drejtimin e dizajnit të një zgjidhjeje për veriun.** Ka pak gjasa që Prishtina dhe Beogradi të dalin me opsione, dhe nëse e bëjnë këtë, ato opsione, sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishin të pranueshme për palën tjetër. Përfshirja e komunitetit ndërkombëtar është e pazëvendësueshme.
3. **Marrëveshjet mes Prishtinës dhe Beogradit duhet të implementohen të plotë dhe në kohë.** Komuniteti ndërkombëtar duhet të ushtrojë trysni tek palët, për ta implementuar marrëveshjen e dakorduar, në kohe dhe të plotë. Vonesat në implementim do të dekurajonin palët për të vazhduar diskutimet dhe për të arritur marrëveshje të reja, dhe kjo do t'i jepte besueshmëri argumentit të forcave opozitare në Kosovë dhe Serbi se dialogu është i padobishëm.
4. **Serbët e Kosovës duhet të përfshihen në dialog.** Ata duhet të përfshihen drejtpërdrejt apo tërthorazi – përmes pjesëmarrjes në ekipet e dialogut apo konsultimeve të rregullta me udhëheqësit e dialogut – në bisedimet mes Beogradit dhe Prishtinës.
5. **Një organizatë me qëndrim neutral ndaj statusit – siç është OSBE-ja – do të mund të organizonte zgjedhjet lokale në veri.** Prishtina dhe Beogradi duhet t'i bejnë thirrje OSBE-së që ajo t'i organizojë zgjedhjet në veri dhe të ndihmojë në vendosjen e institucioneve lokale të pranueshme për të gjithë hisedarët.

SFIDAT E NORMALIZIMIT

Stamboll, Turqi, dhjetor 2012

Në tryezën e dytë të rrumbullakët ka vazhduar diskutimi për veriun e Kosovës. Ky diskutim poashtu ka adresuar dialogun dhe normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë. Edhe pse pjesëmarrësit kanë pasur qëndrime të ndryshme rreth asaj se si do të duhej dukur zgjidhja për veriun, ata kanë propozuar një numër hapash për ndërtimin e besimit për ti krijuar kushtet për një zgjidhje. Ata kanë rekomanduar zgjerimin e bashkëpunimit mes Prishtinës e Beogradit në fusha jopolitike dhe në organizimin e zgjedhjeve lokale në veri nga një organizatë ndërkombëtare. Por ata nuk janë pajtuar rreth asaj se ligjet zgjedhore të kujt do të duhej aplikuar. Përdërisa pjesëmarrësit shqiptarë kanë mbajtur qëndrimin se ligjet e Kosovës nuk janë të negociueshme, shumica e pjesëmarrësve serbë kanë insistuar për ligjet e Serbisë.

Ka ekzistuar një konsensus se dialogu Prishtinë-Beograd duhet të vazhdojë, dhe se marrëveshjet duhet të implementohen në kohë dhe të plotë. Normalizimi i marrëdhënieve është definuar si bashkëpunim i plotë mes Kosovës e Serbisë, por pa njohjen nga Serbia të pavarësisë së Kosovës.

Zgjedhjet dhe institucionet lokale

Veriu vazhdon të udhëhiqet nga institucionet lokale serbe, edhe pse Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar nuk i njohin ato. Një zgjidhje e mundshme mund të jetë mbajtja e zgjedhjeve të organizuara nga një organizatë ndërkombëtare që do të rezultonte në vendosjen e institucioneve legjitime dhe legale. Disa kanë thënë se do të ishte e vështirë të organizohen zgjedhje para se të arrihej një marrëveshje gjithëpërfshirëse politike. Një folës ka propozuar që zgjedhjet e para të organizohen në pajtim me ligjet e Serbisë, të pasuara nga zgjedhjet e Kosovës. Një tjetër folës ka thënë se, në parim, një palë zgjedhje të tilla do të ishin një opsion i mirë, por ka shtuar se do të ishte e vështirë që kjo “t’u shitej kryeqendrave të huaja dhe Prishtinës”. Një numër i folësve shqiptarë, megjithatë, kanë thënë se Prishtina nuk do të pajtohej të organizonte qoftë edhe një palë zgjedhje në territorin e Kosovës në bazë të ligjeve të Serbisë.

Ekzistimi i strukturave joformale të sigurisë është konsideruar si një pengesë madhore për normalizimin e situatës në veri. Edhe pse një numër i pjesëmarrësve serbë kanë mohuar ekzistencën e tyre, pjesëmarrësit shqiptarë kanë thënë se këto struktura duhet të adresohen në dialogun e Brukselit. Megjithatë, shumë pak kanë pritur që Beogradi t’i shpërbëjë strukturat e tij të sigurisë para se të arrihej një marrëveshje.

Një folës ka propozuar që një marrëveshje mes Beogradit e Prishtinës do të duhej tu lejonte katër komunave në veri krijimin e asociacionit të komunave me shumë serbe. Ai ka argumentuar se një asociacion i tillë nuk do të ishte në kundërshtim më frymën e planit të Ahtisaarit; ai do ta përfaqësonte vetëm një “Ahtisaari-plus”. Një tjetër folës ka thënë se pasi që dy të tretat e popullatës së përgjithshme serbe në Kosovës jeton në jug, asociacioni i propozuar do të duhej t’i përfshinte komunat me shumicë serbe në jug.

Shumë pjesëmarrës kanë thënë se Kosovës e Serbisë u mungon kurajo udhëheqëse, e nevojshme për vendime jo edhe aq popullore, por të nevojshme. Kjo është arsyeja pse trysnia e komunitetit ndërkombëtar do të ishte e nevojshme, jo vetëm për të arritur marrëveshjet por edhe për ti zbatuar ato.

Dialogjet dhe marrëveshjet pasuese – posaçërisht implementimi i IBM-së – janë duke shkaktuar panikë tek serbët e veriut. Ata druajnë se Beogradi do të bejë gjithçka që nevojitet për ta përmirësuar perspektivën e tij për anëtarësim në BE, si rezultat i së cilës interesat e tyre do të sakrifikoheshin. Dialogu është duke lëvizur më shpejtë se sa që shumë e kanë pritur. Disa folës kanë thënë se arritja e marrëveshjeve të reja, dhe zbatimi i tyre, tregojnë se problemet e mbetura do të zgjidhen më shpejtë se që shumë besojnë. Pjesëmarrësit kanë thënë se vetë ata do të duhej të jenë më realist, dhe tu ndihmojnë qeverive të tyre për të arritur marrëveshje të reja dhe për ti implementuar ato të vjetrat, me qëllim që të ngritet përkrahja publike për dialogun si në Kosovë ashtu edhe në Serbi.

Normalizimi i veriut

Dialogu teknik mes Prishtinës e Beogradit, gradualisht është duke u transformuar në një dialog politik, me takime mes kryeministrave të Kosovës e Serbisë, ku gjithnjë e më shumë adresohen çështje të qarta politike. Edhe pse një numër i marrëveshjeve tashmë janë arritur, zbatimi i tyre është duke vonuar. Interpretimet e kundërta poashtu dekurajojnë përkrahjen e publikut për procesin. Mes zhvillimesh tjera madhore është edhe marrëveshja për të krijuar një fond zhvillimor për veriun, të financuar nga të hyrat doganore nga dy pikëkalimet në veri, si dhe nga grantet nga Komisioni Evropian dhe qeveria e Kosovës.

Një numër hapash janë propozuar për normalizimin e situatës në veri: patrullimet e përbashkëta policore të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), KFOR-it dhe Policisë së Kosovë (KP); vendosja e një gjyqësori të pranueshëm; pjesëmarrja e rritur politike e serbëve në veri; shpërbërja e strukturave joformale; përgatitja e zgjedhjeve lokale në veri; mosndërmarrja e veprimeve të njëanshme; promovimi i lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave; dhe implementimi i plotë i IBM-së.

Ka ekzistuar një konsensus i përgjithshëm se zgjidhja e çështjes së veriut është kyç për normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës e Beogradit. Pjesëmarrësit kanë thënë se hapat e ardhshëm duhet të jenë zgjidhja e çështjeve të telekomunikimit dhe energjisë; zgjidhja e çështjes së sigurimeve të veturave; shkëmbimi i zyrtarëve ndërlidhës politik e ekonomik; dhe vendosja e lidhjeve hekurudhore e ajrore mes Beogradit e Prishtinës.

Përfundimet dhe rekomandimet

Më poshte gjendet lista e përfundimeve dhe rekomandimeve të cilat kanë dalur nga diskutimet.

1. **Pjesëmarrësit kanë pasur pikëpamje të ndryshme rreth modeleve të qeverisjes lokale në veriun e Kosovës, por janë pajtuar rreth kostos që paguajnë qytetarët e atjeshëm për shkak të status quo-së.** Disa pjesëmarrës kanë qenë në favor të një

zgjidhjeje të ndërmjetme, e cila mban institucionet ekzistuese paralele, por ruan integritetin territorial të Kosovës. Disa të tjerë kanë insistuar se implementimi i planit të Ahtisaarit është i vetmi opsion.

2. **Pjesëmarrësit kanë mbështetur mbajtjen e zgjedhjeve në veri në vitin 2013, të organizuara nga OSBE-ja, por nuk janë pajtuar rreth kornizës ligjore që do të duhej aplikuar.** Disa folës kanë insistuar në ligjet e Serbisë, përderisa të tjerët në ligjet e Kosovës. Edhe pse rregullat e zgjedhjeve “neutrale” do të mund të gjendeshin për të organizuar zgjedhje, një marrëveshje mbi atë se legjislacioni i kujt do të aplikohet pas zgjedhjeve do të ishte më e vështirë. Dhe një palë zgjedhje, pa një marrëveshje të tillë, do të ishin të padobishme.
3. **Strukturat joformale të sigurisë në veri paraqesin kërcënim për zbatimin e marrëveshjeve dhe për stabilitetin e përgjithshëm.** Pjesëmarrësit shqiptarë kanë propozuar shpërbërjen e këtyre strukturave, si një hap para drejt zgjidhjes përfundimtare të çështjes së veriut. Por shumë folës serbë kanë mohuar ekzistencën e strukturave të tilla. Shumë nga ta kanë propozuar që siguria të diskutohet në dialogun e Brukselit.
4. **Akterët kanë ndikim joproporcional në veri.** Pjesëmarrësit janë pajtuar se Beogradi ka më shumë ndikim në veri, se sa vetë serbët e veriut, të cilët, nga ana tjetër, kanë më shumë ndikim se Prishtina. Përpjekjet e Prishtinës për të hapur zyret në veri shihen si një tentim për të rritur indikimin e saj në dëm të Beogradit dhe serbëve të veriut. Ndikimi i serbëve të veriut është duke u reduktuar. Marrëveshja e IBM-së ka treguar se Beogradi dhe Prishtina mund të arrijnë dhe të implementojnë marrëveshje pa pëlqimin e tyre. Serbët e veriut nuk kanë qenë në gjendje ta minojnë procesin e implementimit. Nuk është e qartë nëse ata dëshirojnë të kenë një rol në procesin e të bërit pazar, apo të vazhdojnë ta mbështesin bllokadën të cilën komuniteti ndërkombëtar, Beogradi dhe Prishtina duan ta heqin. Nëse ata refuzojnë bashkëpunimin, ndikimi i tyre i tanishëm mund të reduktohet edhe më tej.
5. **Normalizimi i marrëdhënieve mes Serbisë e Kosovës është definuar si “bashkëpunim pa njohje”.** Implementimi i marrëveshjeve do të mund të përmirësonte marrëdhëniet duke thithur pakënaqësitë e popujve në Kosovë e Serbi, duke lehtësuar ndalesat – eliminimi i pagesave për sigurim të veturës, njohja e tabelave të regjistrimit, etj. Beogradi e Prishtina duhet poashtu të inkurajohen që rregullisht dhe në mënyrë të drejtë ta informojnë publikun e tyre rreth përmbajtjes së marrëveshjeve.

PËRGATITJA PËR TRANZICION

Stamboll, Turqi, mars 2013

Pjesëmarrësit kanë qenë të sigurtë se një marrëveshje gjithëpërfshirëse do të arrihej shumë shpejtë mes Prishtinës e Beogradit. Shumë pjesëmarrës kanë thënë se marrëveshjet duhet të kenë edhe afate dhe orare të zbatimit. Shumë folës kanë besuar se palët nuk kanë shumë opsione dhe se më vonë nuk do të mund të marrin atë që iu ofrohet sot. Komuniteti ndërkombëtar duhet të sigurohet që të mos ketë humbës në këtë dialog.

Disa pjesëmarrës kanë parashikuar se zbatimi i marrëveshjeve do të jetë mjaft i vështirë, përderisa disa prej pjesëmarrësve ishin skeptik nëse marrëveshjet do të zbatoheshin. Si Prishtina ashtu edhe Beogradi kanë zvarritur implementimin e marrëveshjeve të kaluara. Përderisa Prishtina mund t'i ngadalësojë pjesët e marrëveshjeve që nuk i pëlqejnë, Beogradi do ta kishte mjaft të vështirë t'ua shpjegontë serbëve në veri benefitet e marrëveshjeve si dhe t'i bindte ata që mos ta pengojnë procesin.

Një numër i folësve shqiptarë të Kosovës kanë thënë se Beogradi nuk duhet të jetë shumë i përfshirë në zbatimin e marrëveshjeve në territorin e Kosovës dhe se institucionet e Kosovës dhe serbët në veri duhet të jenë aktorët kryesor implementues.

Një folës i afërt me procesin e dialogut në Bruksel ka thënë se në teori duket mirë të kemi marrëveshje të detajuara, por kjo nuk funksionon në praktikë. Ai poashtu ka parashikuar se implementimi do të jetë i vështirë, me shumë interpretime, por ka thënë se “kjo është natyra e procesit”. Ai ka theksuar se afatet dhe oraret janë të mira por “kësaj rradhe ato nuk do të jenë strikte, sidomos pasiqë nuk mund të japim dënime për mosimplementim”.

Roli i partive politike në dialog është konsideruar i rëndësishëm. Një folës nga Prishtina ka thënë se partia e tij mbështet dialogun, por jo pa kushte. Një anëtar tjetër i një partie tjetër opozitare në Kosovë poashtu ka thënë se partia e tij e mbështet dialogun, por vetëm përderisa marrëveshjet e arritura janë në pajtim me sistemin e Kosovës.

Partitë politike në Serbi poashtu mbështesin dialogun. Disa folës, megjithatë, kanë thënë se SNS-ja duhet të jetë më e përfshirë në proces, përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejt të kryetarit të saj në dialog. Partitë politike serbe, e sidomos ato në pushtet, SNS-ja dhe SPS-ja, duhet të përfshihen më shumë në veri me qëllimin për t'i bindur njerëzit atje për pranimin e marrëveshjeve.

Duke marrë parasysh se shumica e pjesëmarrësve kanë besuar se marrëveshja është e paevitueshme, një pjesë e diskutimeve i është dedikuar periudhës kalimtare. Shumë kanë pritur që do të ketë frustrim dhe pakënaqësi të shumta me marrëveshjet eventuale. Edhe pse çështja kryesore do të jetë transformimi i institucioneve të tanishme, debati është fokusuar më shumë në propozimin e asociacionit të komunave dhe nëse ky asociacion do të duhej të kishte fuqi legjislative dhe ekzekutive.

Një folës ka thënë se asociacioni i komunave duhet të ketë të drejtën e bashkëpunimit ndërkufitar dhe se zgjedhjet duhet të jenë pjesë e marrëveshjes së përgjithshme.

Megjithatë, një folës tjetër ka thënë se zgjedhjet në veri duhet të jenë hapi i parë i tranzicionit, kurse krijimi i asociacionit hapi i dytë. Ai poashtu ka shtuar se kryetarët e komunave në veri duhet të angazhohen për implementimin e marrëveshjeve.

Disa nga pjesëmarrësit kanë pyetur se si do të shkonte procesi në rast të dhunës në veri. "Ne zakonisht harrojmë se çka ka në terren, se cilat janë gjërat që serbët në veri po mundohen ti mbrojnë? Serbët në veri do t'i rezistojnë ndryshimit". Posaçërisht e ndjeshme do të jetë çështja e strukturave paralele.

Çështje tjera të ndjeshme janë dokumentet që do të përdoren nga votuesit në veri, listat e votuesve dhe çështja e regjistrimit të partive. Partia opozitare dhe kundërshtuese të marrëveshjeve, Partia Demokratike e Serbisë (DSS), ka pushtetin në dy komunat në veri, që në këtë rast paraqet disavantazh për partitë serbe të koalicionit qeveritar. Këta kryetarë komunash sigurisht do të jenë kundër çfarëdo marrëveshjeje. Disa kanë propozuar gjetjen e mënyrave për të përfshirë këta njerëz në dialog. Beogradi poashtu duhet të jetë i qartë rreth pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhjet dhe institucionet e Kosovës dhe ta përkrahë këtë përfshirje.

Një folës ka thënë se menjëherë pas marrëveshjes duhet të ofrohen shërbime më të mira për serbët në veri, siç janë uji dhe energjia elektrike, si shenjë se progresi politik mbërthen përfitime të dukshme. Një rekomandim tjetër ka qenë që të bëhen investime ekonomike e financiare menjëherë pas arritjes së marrëveshjes. Në këtë kontekst, fondi zhvillimor për veriun duhet të aktivizohet sa më shpejtë.

Përfundimet dhe rekomandimet

Një numër përfundimesh e rekomandimesh kanë dalë nga kjo tryezë e rrumbullakët.

1. **Krijimi i një organizmi për monitorimin e implementimit.** Një organizëm i përbashkët i udhëhequr nga BE-ja duhet të krijohet me qëllim të monitorimit të implementimit të marrëveshjeve. Kurdo që të jetë e mundur, dënimet duhet bashkangjitur rasteve të mosimplementimit. Institucionet e Kosovës dhe serbët në veri duhet ta kryesojnë implementimin, por Beogradi do të mund të ndihmonte për krijimin e një atmosfere më të mirë për procesin e implementimit.
2. **Të mos japin interpretime kundërshtuese.** Prishtina e Beogradit duhet të pajtohen që të mos japin deklarata kundërshtuese rreth dialogut dhe marrëveshjeve. Nëse kjo vazhdon të ndodhë, BE-ja duhet t'i qartësojë këto deklarata.
3. **Marrëveshjet e arritura duhet të implementohen në tërësi.** Pjesëmarrësit janë pajtuar se të gjitha palët duhet të jenë pjesëmarrës në procesin e implementimit. Shqiptarët insistojnë që Prishtina është akteri kryesor, kurse serbët thonë se vetëm Beogradi mund të ndryshojë mendjen e serbëve në veri dhe t'i bindë ata t'i implementojnë marrëveshjet.
4. **Beogradi duhet t'i inkurajojë institucionet lokale në veri që të ndihmojnë në implementimin e marrëveshjeve dhe të organizojnë fushata publike atje.** Beogradi duhet t'i inkurajojë serbët në Kosovë dhe sidomos ata në veri që të marrin pjesë në jetën politike dhe institucionet e Kosovës.

5. **Të qartësohet procesi i transformimit institucional.** Marrëveshjet duhet ta qartësojnë se cilat struktura paralele në veri (p.sh. mbrojtja civile, gjyqësori, qeveria komunale, shëndetësia, arsimi) duhet të transformohen, dhe cilat prej tyre duhet të mbesin ashtu si janë, si dhe mënyra se si duhet të zhvillohet ky proces.
6. **Të ngritet bashkëpunimi i sigurisë.** Bashkëpunimi mes serbëve në veri, EULEX-it dhe KFOR-it duhet të forcohet gjatë kohë së tranzicionit. Krijimi i sigurise dhe luftimi i krimit të organizuar në veri janë kyç.
7. **Beogradi dhe Prishtina duhet të fillojnë të bashkëpunojnë me OSBE-në për përgatitjen e tranzicionit politik dhe të zgjedhjeve të ardhshme lokale në veri.** Gjithashtu, nëse partitë e regjistruara në Serbi kanë në plan të marrin pjesë në zgjedhjet eventuale në veri, ata duhet të fillojnë procesin e regjistrimit në Kosovë.

IMPLEMENTIMI I MARRËVESHJES

Stamboll, Turqi, qershor 2013

Paqaartësia mbretëron në veri të Kosovës në kohën kur Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar kanë filluar implementimin e marrëveshjes për integrimin e këtij rajoni në sistemin e Kosovës. Shumë serbë në veri ende mbeten kundërshtues ndaj integritetit dhe thonë se janë të befashuar nga pëlqimi i Beogradit për shpërbërjen e institucioneve serbe dhe integrimin e tyre në një shtet të cilin ai vetë nuk e njeh. Përfaqësuesit e katër komunave paralele në veri e kundërshtojnë marrëveshjen dhe refuzojnë të marrin pjesë në zbatimin e saj. Për më shumë, ata kanë shpallur kuvendin e tyre autonom për t'i mbajtur, siç thonë ata, në kuadër të kushtetutës së Serbisë. Edhe pse dialogu ka konfirmuar se zgjidhja për veriun varet nga vendimet e bëra nga Prishtina dhe Beogradi, ai poashtu ka treguar se serbët e veriut janë një forcë e cila duhet të merret në konsideratë. Ata nuk kanë fuqi të mjaftueshme për të parandaluar implementimin, por kanë kapacitet të mjaftueshëm për ta ndërprerë dhe për ta vonuar procesin. Shëndrrimi i mosbindjes së tyre në bashkëpunim është thelbësor për implementimin e suksesshëm të marrëveshjes.

Dyshimet dhe rezistenca ndaj marrëveshjes ekzistojnë edhe në mesin e popullatës shqiptare të Kosovës. Shumica e interpretojnë këtë si diçka e cila i jep veriut një status autonom me kapacitet për të minuar shtetin e Kosovës. Shumica e partive politike në opozitë kanë ofruar përkrahjen e tyre vetëm pas tryenisë së fuqishme ndërkombëtare. Disa nga anëtarët e partive politike në qeveri janë poashtu kundër marrëveshjes. Mendimi më i pranishëm është se institucionet e tanishme të Serbisë në veri mund të integrohen në institucionet e Kosovës, por ato do të mbeten lojale ndaj Beogradit dhe do të vazhdojnë të minojnë shtetin e Kosovës nga brenda.

Kritikët thonë se Prishtina dhe Beogradi kanë bërë pak progres në bindjen e publikut të tyre skeptik për ta përkrahur dialogun dhe marrëveshjen. Kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë janë fokusuar kryesisht në pozicionimin e tyre karshi komunitetit ndërkombëtar,

si politikanë pragmatik, të gatshëm për t'u marrë me probleme të vështira, por i kanë neglizhuar bazat e tyre në shtëpi. Shumë thonë se Prishtina dhe Beogradi kanë qenë të njohur për prezentimin 'kreativ' të informatave në lidhje me dialogun. Njerëzit në Kosovë dhe Serbi shohin versione të ndryshme të marrëveshjes së njëjtë.

Shëndrrimi i kundërshtimit në bashkëpunim

Siç është treguar edhe nga një numër i protestave, një pjesë e madhe e popullatës serbe në veri është kundër integritit në institucionet e Kosovës. Edhe pse disa preferojnë qasje më pragmatike, një numër i madh kundërshton çkado që është më pak se ndarja. Shumë thonë se është e vështirë të integrohen në një shtet tjetër pas funksionimit për katërmëdhjetë vite si pjesë e Serbisë. Poashtu duket sikur ritmi dhe shtrirja e dialogut i ka zënë shumë në befasi, duke e bërë kështu të vështirë për ta përshtatjen në rrethanat që po ndryshojnë shumë shpejtë. Një numër i vogël kanë parashikuar se brenda një viti, Prishtina dhe Beogradi do të mund të arrijnë një marrëveshje të tillë gjithëpërfshirëse.

Përfaqësuesit e katër komunave paralele janë në vijën e parë të frontit të kundërshtimit të marrëveshjes, edhe pse edhe ata që operojnë me institucionet shërbyese janë po aq kundërshtues. Shumë diskutues kanë thënë se shëndrrimi i këtij kundërshtimi në bashkëpunim do të jetë sfidues, por jo i pamundshëm. Institucionet lokale janë nën autoritetin ligjor të Beogradit, si dhe janë të varur financiarisht nga qeveria e Serbisë, dhe së këndejmi, do të duhet t'u binden vendimeve të saj. Qeveria e Serbisë është e qartë sa i përket qëllimeve të saja për të implementuar marrëveshjen të plotë dhe brenda kornizës kohore për të cilën është rënë dakord. Për më shumë, udhëheqësit e lartë të Serbisë thonë se implementimi nuk ka alternativë, duke bërë të ditur se nëse zbatja e qëndrimeve nuk funksionon, ata mund të përdorin forcën për të siguruar zbatimin e marrëveshjes. Shumë pjesëmarrës u kanë bërë thirrje udhëheqësve lokalë në veri që të marrin rol dhe përgjegjësi më të mëdha në këtë proces, në vend se ta "kundërshtojnë të pandalshmen". Zyrtarët serbë thonë se ata janë të gatshëm të transferojnë disa nga fuqitë vendimmarrëse nga Beogradi tek përfaqësuesit e serbëve lokalë, por serbët lokalë e refuzojnë atë për shkak se, siç ka thënë njëri nga pjesëmarrësit, "në kohëra kritike më e lehtë është t'u bindesh urdhërave se sa të marrësh përgjegjësi".

Implementimi i marrëveshjes së Brukselit mund të ballafaqohet edhe me mosbindje qytetare. Shumë thonë se bindja e popullsisë lokale është më sfiduese se sa marrja e kontrollit mbi institucionet paralele. Një numër pjesëmarrësish kanë propozuar një komunikim më intenziv mes qeverisë së Serbisë dhe serbëve të veriut. Zyrtarë të lartë të Serbisë kanë bërë disa vizita në veri në përpjekje për të qetësuar popullatën. Ata kanë premtuar vazhdimin e ndihmës financiare të Beogradit dhe ruajtjen e vendeve të punës për shërbyesit civil. Ata të cilët janë të njoftuar nga afër me këto vizita thonë se porosia e përgjithshme e Beogradit drejtuar serbëve të veriut ka qenë se "ju mund të mos e përkrahni marrëveshjen, por nuk duhet të ndërmerreni veprime të cilat pengojnë zbatimin e saj". Zyrtarët serbë poashtu janë duke provuar të marrin deri diku nën kontroll debatin publik në veri, i cili deri më tani është dominuar nga një numër i vogël, kundërshtarë të marrëveshjes, si dhe ta shpjegojnë nevojën për kompromis.

Serbët e veriut kanë një listë të gjatë të brengave, disa më realiste e disa më pak realiste. Ata janë të brengosur se transformimi i institucioneve lokale do të ndikojë në vendet e tyre të punës, pensione, kujdes shëndetësor dhe arsim. Ata poashtu frigohen se me zvogëlimin e rolit politik të Beogradit do të vie edhe deri te zvogëlimi i ndihmës financiare. Roli gjithnjë në ngritje i Prishtinës poashtu është brengosës për disa, duke pasur parasysh mungesën e besimit që ata kanë në raport me institucionet e Kosovës. Në mesin e brengave më pak realiste janë edhe supozimet se implementimi do të çojë drejt një eksodusi apo asimilimi të popullsisë serbe.

Në mënyrë që të fitohet mbështetja e serbëve të veriut, pjesëmarrësit kanë propozuar një numër hapash.

1. **Beogradi duhet tu shpjegojë serbëve të veriut se ai merr parasysh interesat e tyre.** Edhe pse interesi nacional ka përparësi në raport me interesat lokale, kur një konflikt mes tyre ekziston, Beogradi duhet t'ua shpjegojë serbëve se i merr parasysh interesat e tyre në çdo fazë të dialogut me Prishtinën. Edhe pse serbët e veriut do të duhet të operojnë brenda kornizës ligjore dhe politike të Kosovës, marrëveshja ofron mjaft mjete mbrojtëse që ata të mund t'i drejtojnë punët e tyre, siç janë formimi i asociacionit të komunave, policia autonome lokale, dhe garancat se Forca e Sigurisë së Kosovës dhe njësitet speciale të policisë nuk do të hyjnë në veri pa pëlqimin e këtyre të fundit.
2. **Faktorët joekonomikë – identiteti, dinjiteti kombëtar, dokumentet e identifikimit, shtetësia – mbesin forca të fuqishme turbulluese.** Këta faktorë formojnë opinionet e serbëve të veriut rreth integritit të tyre në jetën publike të Kosovës. Ata frigohen se integrimi do të thotë edhe ndërrim të identitetit. Edhe ata të cilët janë në favor të integritit janë kundër përdorimit të simboleve të Kosovës dhe kundër dhënies së betimit kur një gjë e tillë kërkohet prej tyre, siç janë rastet në forcat policore dhe në gjyqësor. Edhe pse fokusi i Prishtinës, Beogradit dhe komunitetit ndërkombëtar duhet të mbetet në zhvillimin ekonomik të rajonit, ata duhet ta marrin parasysh ndikimin e këtyre faktorëve joekonomik, me rastin e krijimit të politikave.
3. **Serbët e veriut kanë të drejtë ta kundërshtojnë marrëveshjen përmes mjeteve jo të dhunshme, siç janë protestat apo peticionet.** Megjithatë, nëse individë apo grupe të caktuara përdorin dhunën, autoritetet duhet të veprojnë me vendosshmëri dhe shpejtë për të krijuar një mjedis të sigurtë për të gjithë.
4. **Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet t'u ofrojnë serbëve të veriut më shumë informata rreth marrëveshjes.** Fushata informuese do të duhej të intensifikohej sidomos para zgjedhjeve të 3 nëntorit. Deri më tash, informatat për marrëveshjen kanë qenë interpretative, jo të plota, dhe shpesh nuk janë bërë publike me qëllim. Përvoja na tregon se interpretimet shpesh janë më të fuqishme se faktet.

Edhe pse zgjidhja e mosmarrëveshjes së veriut do të varet nga zgjedhja e politikave dhe nga vendimet e marra në Prishtinë e Beograd, sigurimi i bashkëpunimit nga ana e tyre është kyç për të pasur një proces të qetë të implementimit.

Të votohet apo mos të votohet

Serbët e veriut janë në mëdyshje nëse duhet të votojnë apo jo në zgjedhjet lokale të Kosovës më 3 nëntor. Pjesëmarrja në votime do ta garantonte përfaqësimin e tyre në institucionet e Kosovës, por poashtu do t'u jepte legjitimitet atyre institucioneve, duke bërë kështu që disa ta barazojnë pjesëmarrjen në zgjedhje me njohjen e pavarësisë së Kosovës. Në anën tjetër, bojkotimi i zgjedhjeve do të ishte në përputhje me politikën e mosnjohjes, por rrezikon t'i lërë serbët e veriut pa përfaqësues dhe institucione legjitime për katër vitet e ardhshme. Vazhdimi i paralelizmit poashtu mund të jetë i paqëndrueshëm, ne veçanti pasi Beogradi t'i ketë ndaluar fondet e tij, siç parashihet në marrëveshje.

Shumica e pjesëmarrësve kanë thënë se serbët e veriut duhet të marrin pjesë në zgjedhje, siç parashihet me marrëveshje. Shumë thonë se tashmë që edhe vetë Beogradi është duke bashkëpunuar me institucionet e Kosovës, bojkotimi i po të njejtave institucione nga serbët e veriut është jopraktik dhe joefikas; ata thonë se bojkoti dhe paralelizmi e kanë pasur kohën e tyre. Është e sigurtë se qendrat e votimit kësaj here do të hapen, por nuk dihet nëse një numër i konsiderueshëm i serbëve do të dalin për të votuar. Shumë thonë se një grup i njerëzve të fuqishëm lokal nuk do të marrin pjesë dhe mund të organizojnë fushata me qëllim të frikësimit të popullatës dhe kundër pjesëmarrjes.

Regjistrimi i partive politike mbetet një tjetër çështje e diskutueshme. Serbët preferojnë ti shmangen regjistrimit në Kosovë, ndërsa autoritetet e Kosovës thonë se regjistrimi është i obligueshëm. Të gjitha partitë ekzistuese politike serbe janë nga jugu, dhe asnjë nga to nuk kanë degë në veri. Partitë politike të cilat synojnë të marrin pjesë në zgjedhjet e 3 nëntorit duhet t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre për certifikim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës. Degët në Kosovë të partive të Serbisë nuk do të mund të marrin pjesë në zgjedhje pa u regjistruar në Kosovë.

Pjesëmarrësit serbë kërkuar që serbët e Kosovë të lejohen të votojnë dhe të garojnë në zgjedhje me dokumente të Serbisë. Ligji zgjedhor i Kosovës është duke u interpretuar në mënyra të ndryshme. Edhe votuesit shqiptarë mund të votojnë vetëm me dokumente të Kosovës, zyrtarët e Kosovës pranojnë se do të ketë fleksibilitet për serbët.

Për të siguruar pjesëmarrje solide dhe proces të rregullt zgjedhor, pjesëmarrësit kanë dalë me një numër përfundimesh dhe rekomandimesh.

1. **Partitë politike të serbëve të Kosovës duhet të vendosin një bashkëpunim më të gjërë.** Ata duhet t'i harmonizojnë politikën e tyre, t'i koordinojnë aktivitetet, dhe të veprojnë si aleanca fleksibile politike – jodomosdoshmërisht të garojnë në një listë të përbashkët – në zgjedhjet lokale të 3 nëntorit. Veprimet e koordinuara do të promovojnë kohezion politik e social dhe do të forcojnë fuqinë e të bërit pazar të komunitetit serb në politikën e Kosovës. Këto zgjedhje janë posaçërisht të rëndësishme sepse zyrtarët e zgjedhur do të jenë përgjegjës për krijimin asociacionit të komunave, një institucion ombrellë për komunat me shumicë serbe. Një numër i përfaqësuesve serbë kanë propozuar që serbët të garojnë në një listë të përbashkët, edhe pse shumë pak prej tyre mendojnë që kjo ka gjasa të ndodhë,

duke pasur parasysh ndasitë ekzistuese përbrenda komunitetit serb. Shumë poashtu kanë thënë se është më mirë të ketë dy apo tri lista, pasi që kjo do të ofronte më shumë zgjedhje për votuesit, dhe do të mund të ndihmonte në demokratizimin e komunitetit serb në Kosovë. Në mënyrë që zgjedhjet të jenë të lira dhe të ndershme, dhe në mënyrë që institucionet që dalin nga këto zgjedhje të mund të pretendojnë legjitimitet të gjërë, duhet të krijohen kushtet që të gjitha partitë serbe të operojnë të papenguara në tërë territorin e Kosovës. Përgjegjësia për të krijuar një mjedis të tillë bie kryesisht mbi Beogradin dhe komunitetin ndërkombëtar. Shumica pajtohen se Prishtina ka pak ose aspak ndikim në veri.

2. **Udhëheqësit lokal në veri duhet të përfshihen menjëherë dhe të marrin përgjegjësi për organizimin e zgjedhjeve dhe implementimin e aspekteve të tjera të marrëveshjes.** Ata poashtu duhet të bëhen anëtarë të ekipeve përgatitore, përgjegjëse për tranzicionin institucional. Ekziston konsensusi për atë se nëse udhëheqësit lokal nuk do ta përkrahnin implementimin, ata së paku nuk duhet të ndërmarrin veprime për ta minuar atë.
3. **Siguria duhet të përmirësohet thelbësisht gjatë fushatës elektorale dhe në ditën e votimit.** Policia e Kosovës, KFOR-i dhe EULEX-i do të duhej të ishin institucionet e vetme që ofrojnë siguri. Institucionet tjera të sigurisë duhet të shpërbëhen para se të fillojë fushata dhe grupe të caktuara duhet të parandalohen nga frikësimi i votuesve dhe atyre që garojnë në zgjedhje.

PËRGATITJA PËR ZGJEDHJE

Shkup, Maqedoni, shtator 2013

Veriu i Kosovës i dominuar nga serbët është në dilemë rreth pjesëmarrjes në zgjedhjet e para lokale të Kosovës, qysh nga shpallja e pavarësisë së saj në shkurt të vitit 2008. Edhe pse Beogradi dhe Prishtina janë pajtuar që zgjedhjet e Kosovës të mbahen edhe në veri, të zhbëhen institucionet paralele, dhe të krijohen institucionet lokale të Kosovës, shumë nga përfaqësuesit e komunitetit serb atje janë skeptik rreth votimit dhe formimit të mëturjes të institucioneve. Një numër i madh njerëzish parashikojnë një dalje më të ulët se 20 përqind në zgjedhje, dhe parashikojnë sfida të vështira në krijimin e institucioneve të reja lokale. Veçanërisht sfidues do të jetë integrimi i strukturave serbe të sigurisë në veri në strukturat e Kosovës.

Përfaqësuesit e serbëve në veri tregojnë një numër brengash lidhur me zgjedhjet dhe integrimin pasues në institucionet e Kosovës—siç janë humbja e vendeve të punës si pasojë e reduktimit të parashikuar të administratës lokale, gjasat e vogla që policia e Kosovës t'i punësoje të gjithë oficerët paralel policorë që operojnë në veri, pasiguria rreth vendeve të punës për ata të cilët janë të punësuar në kompani publike jooperative në veri, pagat më të ulëta në institucionet e Kosovës krahasuar me ato të Serbisë—por arsyeja kryesore kundër integritit mbetet refuzimi i shtetit të Kosovës.

Zgjedhjet në veri

Zgjedhjet e Kosovës më 3 nëntor janë zgjedhjet e para lokale që organizohen në veri pas pavarësisë së Kosovës. Serbia dhe banorët lokalë serbë atje kanë organizuar disa zgjedhje të tyre dhe kanë krijuar institucione të cilat operojnë në pajtim me ligjet e Serbisë. Zgjedhjet e reja janë rezultat i marrëveshjes së Brukselit, e cila bën thirrje për zgjedhje në pajtim me ligjet e Kosovës. Shumica e pjesëmarrësve thonë se kjo nuk qartëson se çfarë do të ndodhë me ata të cilët kanë punuar në sistemin paralel serb – nëqoftëse ata të gjithë do të punësohen në institucionet e reja – dhe nuk e shpjegon se në bazë të cilave ligje do të funksionojnë institucionet e reja si dhe marrëdhëniet që do ti kenë ato me Beogradin. Një numër i pjesëmarrësve tjerë, megjithatë, kanë thënë se marrëveshja qartazi tregon se institucionet e reja do të operojnë në pajtim me ligjet e Kosovës, por kanë thënë se zyrtarët qeveritarë të Serbisë nuk e pranojnë këtë publikisht për arsye politike.

Disa folës kanë thënë se koha kur është arritur marrëveshja e Brukselit korrespondon me përpjekjet e shtuara të Serbisë për të shënuar progres drejt integritetit evropian dhe jo me interesat e popullatës lokale në veri. Megjithatë, një numër folësish kanë thënë se kjo mund të jetë e vërtetë, porse zgjedhjet dhe krijimi i institucioneve të pranuar nga Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar janë edhe në interes të komunitetit serb. “Më në fund, veriu do të ketë institucione të njohura nga të gjithë”, ka thënë një folës.

Ka ekzistuar konsensus se politikanët duhet të krijojnë një klimë më të mirë për pjesëmarrje në zgjedhje. Zyrtarët e Kosovës dhe Serbisë duhet të përmbahen nga retorika e cila ngrit tensionet dhe provokon popullatën. Disa prej tyre kanë kritikuar fuqishëm qëndrimin e qeverisë së Serbisë për përkrahjen e vetëm një partie serbe, të njohur si “lista e qeverisë”, duke nënkuptuar kështu se partitë dhe iniciativat tjera serbe nuk përfaqësojnë interesat serbe. Kandidatët për kryetarë komunash duhet të përkrahen dhe të inkurajohen nga të gjitha palët e involvuara në këtë proces. “Disa në qeverinë e Serbisë përkrahin vetëm kandidatë të caktuar duke dëmtuar kështu procesin, veçanërisht në raste kur disa besojnë se vetëm kandidatët të cilët janë në listën e shtetit do të fitojnë vendet e punës dhe benefitet. Nuk është demokratike që qeveria të mundohet t’ua imponojnë qytetarëve mënyrën se si votojnë,” ka thënë një folës.

Pa një klimë më të favorshme politike, shumë folës kanë parashikuar se dalja në zgjedhje do të jetë tepër e ulët. Disa kanë thënë se në rastin më të mirë, dalja do të jetë rreth 20 përqind. Një folës ka thënë se ekzistenca e barrikadave në veri tregon për mungesën e besimit nga ana e serbëve në veri karshi institucioneve të Kosovës dhe refuzimin për integritet. Votuesve duhet treguar se çfare do të sjellin zgjedhjet, ligjet e kujt do të përdoren për krijimin e institucioneve, çfarë do të ndodhë me vendet e tyre të punës, me kontributet e pensionit, kujdesin shëndetësor dhe shkollimin. “Nëse ata nuk marrin përgjigje të sakta në këto çështje, dalja në zgjedhje nuk do të jetë e lartë dhe zgjedhjet nuk do të mund të quhen të suksesshme”, ka thënë një folës. Marrëveshja vetëm thotë se zgjedhjet do të mbahen në pajtim me ligjet e Kosovës, por nuk thotë se institucionet do të funksionojnë bazuar në ligjet e Kosovës. Për njerëzit në veri, kjo nuk ka të bëjë me

zgjedhjet; e gjitha ka të bëjë me statusin e tyre, me ate nëse do të bëhen kosovarë, apo do të mbeten qytetarë serbë, ka thënë një diskutues tjetër.

Siguria gjatë zgjedhjeve mbetet brenga më serioze. Disa folës kanë thënë se në veri ekzistojnë disa struktura të sigurisë të cilat do të mund ta kërcënonin procesin, dhe kanë sygjerruar që EULEX-i dhe KFOR-i të jenë më aktiv. Ata poashtu kanë rekomanduar që Beogradi duhet të jetë më i vendosur dhe t’u dërgojë një mesazh të qartë atyre që mund të planifikojnë të gjejnë ngushëllim në mjetet e dhunshme.

Për të krijuar klimë të favorshme për zgjedhje të lira dhe të drejta, pjesëmarrësit kanë propozuar një numër hapash:

1. **Qeveria e Serbisë nuk duhet të mbajë anë mes partive politike serbe të Kosovës që garojnë në zgjedhje.** Beogradi duhet t’i mbështesë të gjitha partitë partitë serbe në mënyrë të barabartë dhe mos të mbështesë njërin apo tjetrin. Deklaratat e zyrtarëve serbë të cilat u bëjnë thirrje votuesve serbë që ta përkrahin listën e qeverisë nuk janë demokratike dhe kontribuojnë në ndarjen e komunitetit serb. Pozicioni i Beogradit që ta përkrahë një parti i ndanë politikanët serbë në patriotë dhe tradhëtarë dhe nënkupton që ato parti të cilat nuk janë pjesë e “listës” nuk përfaqësojnë interesat e serbëve. Partitë serbe, përfshirë këtu edhe partitë në qeveri, do të mund të mbështesnin parti të caktuara, por këtë nuk duhet ta bëjë qeveria e Serbisë. Kjo është lista SNS-SPS, e jo lista e qeverisë.
2. **Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet ta ofrojnë sigurinë e atyre të cilët marrin pjesë në garë dhe të parandalojnë kërcënimin e votuesve.** Policia e Kosovës, EULEX-i, KFOR-i dhe shërbimi inteligjent i Beogradit duhet të bashkëpunojnë për të ofruar siguri për ata të cilët garojnë në këto zgjedhje dhe t’i dobësojnë fushatat kërcënuese. Ata poashtu duhet të bashkëpunojnë ngushtë në ndriçimin e incidenteve të fundit të kërcënimeve kundër kandidatëve për zgjedhjet në veri, e sidomos në identifikimin dhe kapjen e vrasësve të oficerit të policisë së EULEX-it. Këto institucione duhet tu dergojnë mesazh të qartë atyre që i kryejnë këto krime, se veprimet e tyre nuk do të kalojnë pa u ndëshkuar, duke vepruar shpejtë dhe duke i zgjidhur këto raste.
3. **Prishtina, Beogradi dhe serbët në veri duhet të përmbahen nga deklaratat dhe veprimet provokative gjatë fushatës zgjedhore.** Këta akterë duhet të marrin përgjegjësi për të siguruar zgjedhje të suksesshme dhe për të shmangë deklaratat dhe veprime të tilla të cilat do të mund ta minonin daljen në zgjedhje. Prishtina duhet ti lejojë zyrtarëve serbë ta vizitojnë Kosovën. Beogradi duhet të fokusohet në çështje të interesit lokal dhe të mos interpretojë pjesëmarrjen si “fuqizim të shtetit serb në Kosovë” por si “fuqizim të komunitetit serb në Kosovë”. Kandidatët serbë në veri duhet të fokusohen në çështjet lokale dhe të mos përdorin retorikë nacionaliste gjatë fushatës. Zgjedhjet e suksesshme nuk do të kishin ndikim të madh vetëm në sigurimin e një ardhmërie më të mirë për veriun, por do ti përmirësonin marrëdhëniet mes Beogradit e Prishtinës dhe do të krijonin klimë të favorshme për besim dhe bashkëpunim ndëretnik në gjithë Kosovën.

Krijimi i institucioneve lokale

Sipas ligjeve të Kosovës, komunat kanë autonomi thelbësore në planifikimin dhe shpenzimin buxhetor, por shumica e fondeve vijnë nga grantet e qeverisë. Për të pranuar grante të tilla, komunat duhet të pranojnë dhe të bashkëpunojnë me autoritet qendrorë në Prishtinë. Beogradi nuk do të vazhdojë financimin e strukturalë politike. Së këndejmi, bashkëpunimi mes institucioneve lokale në veri dhe Prishtinës është thelbësor.

Dalja në zgjedhje është një tjetër faktor i rëndësishëm për legjitimitetin e institucioneve. “Këto zgjedhje janë më shumë një referendum për integrimin në sistemin e Kosovës së sa zgjedhje për krijimin e institucioneve.” Dalja e ulët mund ta bëjë të vështirë për zyrtarët e zgjedhur që të kenë legjitimitet më të gjërë. Pasiguria është faktori kryesor për daljen e ulët që pritet të ndodhë. Është e paqartë se sa vëmendje politike dhe financiare do t’ia kushtojë Prishtina këtij rajoni. Dhe çka është e sigurtë është se popullata lokale do ta bartë koston e tranzicionit, por ata poashtu do ti korrin përfitimet. Shumica ndjehen të tradhëtuar nga Beogradi që pas 14 viteve është duke i hedhur në një të ardhme të paqartë. Por njerëzit në veri mund ta krijojnë këtë qartësi duke u përfshirë vetë në proces dhe duke mos pritur që këtë ta bëjë Brukseli, Prishtina apo Beogradi. Porosia e pjesëmarrësve ka qenë që autoritetet e Kosovës do të duhej të mbështesnin veriun financiarisht dhe politikisht dhe “ta trajtojnë atë si territor dhe popullsi të veten”.

Për të krijuar institucione funksionale në veri, pjesëmarrësit kanë propozuar një numër hapash:

1. **Të gjitha palët do të duhej të fokusoheshin në krijimin e stabilitetit politik në veri.** Serbët në veri do të duhej të bashkëpunonin me Prishtinën, Beogradin dhe komunitetin ndërkombëtar. Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet ta zbusin koston e tranzicionit duke hapur vende pune në administratën publike, duke krijuar fondin zhvillimor dhe duke inkurajuar investime private. Ata poashtu duhet t’i bejnë më të dukshme përfitimet e tranzicionit.
2. **Organizatat ndërkombëtare, si OSBE-ja, duhet të organizojnë trajnime për zgjedhjet dhe për zyrtarët e administratës lokale.** Hisedarët lokal dhe ndërkombëtar duhet të fokusohen në ndërtimin e një administrate lokale efikase dhe profesionale. Shërbimet efikase do ta rrisnin besueshmërinë e këtyre institucioneve në sytë e publikut dhe do ti zbusnin kundërshtimet politike të cilat i kanë serbët në veri kundrejt institucioneve lokale të Kosovës. Në këtë aspekt, Prishtina dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë, si OSBE-ja, Komisioni Evropian, ambasadat, duhet t’i mbështesin programet trajnuese për stafin administrativ.
3. **Vendosja e marrëdhënieve të punës me institucionet qendrore të Kosovës.** Pjesa më e madhe e buxheteve komunale vjen nga grantet e qeverisë së Kosovës, për shkak se të hyrat lokale janë të vogla. Kjo do të ndodhë edhe me komunat në veri. Së këndejmi, është shumë e rëndësishme të vendoset një marrëdhënie e mirë me institucionet qendrore në mënyrë që të pranohen grantet në kohë dhe që të kërkojnë fonde specifike për fusha të caktuara që kanë më së shumti nevojë.

NDËRTIMI I INSTITUCIONEVE NË VERI

Bruksel, Belgjikë, dhjetor 2013

Serbët e veriut kanë votuar në numër të dukshëm në zgjedhjet e 3 nëntorit. Në gjithë Kosovën, list Srpska e përkrahur nga Beogradi ka fituar 9 nga 10 komunat me shumicë serbe, përfshirë katër komunat në veri. Edhe pse të përshkuara me parregullsi dhe një fushatë agresive e frikësimit, zgjedhjet në veri kanë qenë të suksesshme sepse kanë prodhuar zyrtarë të zgjedhur dhe kanë krijuar kushtet për krijimin e institucioneve të njohura nga të gjitha palët.

Megjithatë, procesi i integritetit përfshin një numër hapash sfidues në ditët në vazhdim. Këto sfida përfshijnë krijimin e institucioneve të reja lokale dhe transformimin e të vjetrave, funksionimin e këtyre institucioneve në pajtim me ligjet e Kosovës, bashkëpunimin mes institucioneve lokale dhe institucioneve qendrore të Kosovës, si dhe formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe. Këta hapa kanë qenë në fokus të tryezës së gjashtë dhe të fundit të këtij projekti, të mbajtur me 5-6 dhjetor, në Bruksel, Belgjikë. Një numër pjesëmarrësish nga Kosova dhe Serbia poashtu kanë pasë një diskutim me një numër të Delegacionit të Parlamentit Evropian për Ballkanin Perëndimor.

Përfaqësuesit e sapozgjedhur në veri kanë qenë më të zëshmit në kundërshtimin e institucioneve të Kosovës, por tani ata duhet t’i krijojnë dhe udhëheqin vetë këto institucione. Prishtina poashtu kishte refuzuar të takohet me shumë nga këta përfaqësues kur ata kanë qenë në krye të institucioneve paralele, por tani do t’i duhet të bashkëpunojë me ta. Shumë prej pjesëmarrësve në takim presin që kjo marrëdhënie do të jetë e tensionuar dhe sfiduese. Testi i parë është inaugurimi i asambleve komunale dhe krijimi i administratës në pajtim me ligjet e Kosovës.

Pjesëmarrësit kanë rekomanduar që kryetarët e komunave duhet të fillojnë komunikimin me Prishtinën menjëherë dhe në pajtim me ligjet ekzistuese. Ata posaçërisht kanë inkurajuar kryetarët e komunave që të fokusohen më shumë në politikatat të cilat adresojnë brengat lokale të zgjedhësve të tyre – uji, energjia elektrike, dhe infrastruktura rrugore – dhe më pak në politikë. Kryetarët poashtu duhet të krijojnë sa më parë administrate lokale dhe të fillojnë me ofrimin e shërbimeve. Pjesëmarrësit kanë përkrahur implementimin e plotë të marrëveshjes së Brukselit dhe u kanë bërë thirrje të gjitha palëve që t’i kryejnë obligimet e tyre. Ka pasë konsensus se stabiliteti politik është kyç për zhvillimin ekonomik të veriut, posaçërisht për shkak të asistencës së huaj, dhe u është bërë thirrje kryetarëve që të krijojnë një ambient të përshtatshëm për asistencën dhe investimet e huaja.

Krijimi i institucioneve lokale

Një numër pjesëmarrësish kanë konkluduar se transformimi i institucioneve paralele serbe në veri në institucione të Kosovës përmes zgjedhjeve lokale të Kosovës, duket të jetë proces më i komplikuar se sa krijimi i komunave me shumicë serbe në jug të lumit Ibër, katër vite më parë. Posaçërisht i komplikuar është integrimi i qindra anëtarëve të

strukturave joformale të sigurisë, siç janë mbrojtja civile dhe oficerët e policisë së Serbisë, në strukturat respektive të sigurisë. Autoritetet e Serbisë i kanë dorëzuar autoriteteve të Kosovës një listë prej 337 anëtarëve të policisë së Serbisë, ndërsa autoritetet e Kosovës do të rekrutojnë mes 250 dhe 270 oficerë në forcën policore. Agjencioni i inteligjencës i Kosovës dhe EULEX-i janë duke i rishikuar aplikacionet. Anëtarët e mbrojtjes civile gjithashtu do të integrohen në forcën e policisë dhe sigurisë në bazë të procedurave të njejta.

Shqiptarët e Kosovës vënë në pikëpyetje lojalitetin e këtyrë anëtarëve karshi institucioneve të Kosovës. Disa kanë thënë se ata kanë qenë jo vetëm në ballë të rezistencës kundër institucioneve të Kosovës, por ata poashtu refuzojnë ta njohin sovranitetin e Kosovës. Shumë folës kanë thënë se deklaratat e zyrtarëve të ndryshëm të Serbisë se institucionet e reja lokale do të “fuqizojnë shtetin e Serbisë në Kosovë” nuk kontribuojnë për një klimë të bashkëpunimit dhe tolerancës. Një numër i folësve serbë kanë thënë se integrimi i anëtarëve serbë do të bëhet sipas marrëveshjes së Brukselit, marrëveshje kjo e cila, sipas tyre, është neutrale ndaj statusit. Disa nga zyrtarët kanë thënë se ata nuk do ta njohin pavarësinë e Kosovës dhe institucionet e saj, por se do të provojnë të bashkëpunojnë me ta në frymën e marrëveshjes. Ata janë pajtuar që ta bëjnë betimin me rastin e marrjes së detyrës, por jo “sepse ata e njohin pavarësinë e Kosovës, por sepse betimi nuk përmend askund Republikën e Kosovës”. Edhe pse kjo mund të ndihmojë në krijimin e administratës, një gjë e tillë nuk është zgjidhje sepse kryetarët e komunave që nga dita e parë në punë do të ballafaqohen me shume dokumente me simbolet e Republikës së Kosovës.

Testi parë do të jetë inaugurimi i asambleve dhe krijimi i qeverive lokale sipas ligjeve të Kosovës. Në bazë të ligjit për qeverisje lokale, asambletë komunale duhet të inaugurohen 15 ditë pas zgjedhjeve kurse kryetarët 30 ditë pas çertifikimit të rezultatit të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror Zgjedhor. Nëse kryetari nuk e bën betimin, Komisioni organizon zgjedhje të reja. Disa pjesëmarrës serbë kanë propozuar që institucionet lokale të mos formohen derisa të mos formohet asociacioni.

Implementimi i ligjeve të Kosovës nga institucionet lokale në veri është kyç dhe bashkëpunimi i tyre me Prishtinën është vendimtar për integrim të suksesshëm. Të hyrat nga burimet komunale janë të papërfillshme, prandaj komunat mbështeten në fonde nga buxheti qendror. Shumë pjesëmarrës kanë propozuar që kryetarët serbë në veri të fillojnë të flasin me Prishtinën dhe të mos presin që Beogradi t’i diskutojë të gjitha detajet në emër të tyre. Ata kanë rekomanduar që administrata lokale të pranojë staf dhe të fillojë të ofrojë shërbime sa më parë që është e mundur.

Bashkëpunimi është poashtu një kusht i vendosur nga komuniteti ndërkombëtar. Bashkimi Evropian ka ndarë 38.5 milion euro për veriun për vitin e parë, por zyrtarët e saj thonë se fondet varen nga bashkëpunimi i veriut me Prishtinën dhe me komunitetin ndërkombëtar si dhe nga implementimi i ligjeve. Shumë folës kanë thënë se implementimi i ligjeve të Kosovës nuk është i negociueshëm, dhe kanë besuar se fondet e BE-së janë një incentivë serioze. Asistenca financiare e BE-së është domethënëse. Dhe përveç 38.5 milion eurove

të BE-së, katër komunat do të pranojnë fonde shtesë nga autoritetet qendrore, të hyra vetanake lokale, dhe fondi zhvillimor për veriun. Në total, fondet për veriun do të jenë rreth 60 milion euro. Sa për ta ilustruar më mirë, veriut me rreth 40 mijë banorë do të kenë një buxhet sa të Prishtinës, ku jetojnë rreth 200 mijë qytetarë.

Asociacioni – forcë integruese apo ndarëse?

Qëllimi i asociacionit është që ti lidhë komunat me shumicë serbe me njëra tjetrën dhe të shërbejë si një organizatë ombrellë që përfaqëson interesat e komunitetit serb. Zyrtarët e Kosovës kanë thënë se ata pajtohen për asociacionin në këmbim të shpërbërjes së sistemit paralel në veri. Asociacioni mbetet njëra nga çështjet më diskutabile në marrëveshjen e Brukselit. Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës kanë thënë se asociacioni do të ndante edhe më tej shoqëritë shqiptare e serbe, do të krijonte një entitet të veçantë serb brenda Kosovës, dhe do të minonte shtetin e Kosovës dhe konceptin e multi-etnicitetit. Por një numër i folësve serbë kanë thënë se asociacioni do të përfaqësonte interesat e komunitetit serb në një mënyrë më të organizuar dhe do të vepronte si një trup i unifikuar serb në Kosovë. Ata poashtu kanë shtuar se asociacioni duhet të ketë fuqi legjislative dhe ekzekutive, përfshirë edhe disa prej kompetencave që tashmë mbahen nga komunat.

Mandati dhe roli i asociacionit nuk është definuar ende. Kryeministri i Kosovës ka thënë se asociacioni do të jetë thjesht një mekanizëm konsultativ pa kompetenca ekzekutive dhe legjislative. Kryeministri serb, në anën tjetër, ka thënë se asociacioni do të ketë kompetenca ekzekutive në fushën e sigurisë, gjyqësisë, edukimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe zhvillimit ekonomik. Anëtarët e komunitetit ndërkombëtar, përfshirë ambasadorët amerikanë dhe gjermanë në Kosovë, se fundmi kanë thënë në intervista të ndara se ka tendencë nga Beogradi për formimin e verzionit të Republika Srpska në veri, por kanë thënë se ata nuk do të lejojnë një gjë të tillë. Anëtarët e partisë opozitare Vetëvendosje kanë thënë se është e vonshme të ndalohet procesi dhe fajësojnë qeverinë e Kosovës për krijimin e entitetit të veçantë në veri.

Ajo çka dihet për asociacionin është se nuk do të ketë një legjislaviv të zgjedhur dhe se lidhshipi i tij do të përfshijë kryetarë komunash dhe anëtarë tjerë të institucioneve lokale të komunave me shumicë serbe. Disa nga këto komuna, siç janë Novobërda, Shtërpca dhe Mitrovica veriut kanë numër thelbësor të shqiptarëve. Debati rreth këtyre pyetjeve është i tensionuar dhe është duke krijuar tensione mes komuniteteve. Pjesëmarrësit kanë sugjeruar që një marrëveshje për këtë mekanizëm duhet të arrihet sa më shpejtë.

Përfundimet dhe rekomandimet

Në vazhdim është lista e përfundimeve dhe rekomandimeve të dala nga diskutimet.

1. **Dialogu Prishtinë-Beograd rreth çështjeve të brendshme të Kosovës duhet të përmbyllet gradualisht.** Dialogu duhet të vazhdojë rreth çështjeve bilaterale, siç janë bashkëpunimi ekonomik, energjia, bashkëpunimi rajonal, dhe integrimet evropiane. Çështjet e mbetura të brendshme duhet të diskutohen mes Prishtinës dhe serbëve të Kosovës.

2. **Kryetarët duhet të fillojnë të flasin drejtpërdrejt me Prishtinën dhe të mos vazhdojnë të mbështeten tek Beogradi.** Kjo jo vetëm që është një përgjegjësi që u është dhënë atyre nga votuesit, por Beogradi mund të mos jetë në gjendje të negociojë në emër të tyre çdo çështje lokale që mund të paraqitet gjatë implementimit të marrëveshjes. Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, përfshirë kryeministrin dhe kryetarët e komunave në veri, kanë shprehur gatishmërinë që të kenë takime të drejtpërdrejta.
